



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 07/2018

Datë: 12. 03.2018. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Ergit Qeli, kryetar i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Stevan Veslinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Ergit Qeli, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së;
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 05/2018,*
2. Aktivitetet e ZRPP-së
3. Raport i Këshillave të KQZ-së
 - Këshilli i Operacioneve Zgjedhore:
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Vlerësimit të Barazisë Gjinore nga KQZ, Politika e Barazisë gjinore e KQZ-së si dhe Plani i Veprimit të Barazisë Gjinore të KQZ-së,*
 - Këshilli për Buxhet dhe Financa:
 - *Shqyrtim i dhe miratimi i Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të KQZ-së, për vitin 2019-2021,*
3. Të ndryshme;

1. Hyrje: z. Ergit Qeli, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Ergit Qeli: E kemi rendin e ditës...! Para se ta hedhim në votim, a ka ndokush ndonjë sugjerim, vërejtje, propozim...?

Ercan Spat: Ne, me autorizim të kryetare, meqë ajo e kryeson Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë, kemi mbajtur takim para mbledhjes me një pikë të rendit të ditës...Nuk po hy tek tema, por në pikën e tretë “Raporti i Këshillave”, të futet edhe pika “Plani medial 2018”.

Ergit Qeli: Pika e parë “Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 05/2018”, nuk është gati. Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Miradije Mavriqi, drejtoresh e ZRPP-së: Zyra ka përgatitur rekomandim për shqiptim të gjobave për katër subjekte politike: 2 parti politike dhe 2 iniciativa qytetare. Këto, kanë dorëzuar mbas afatit ligjor raportin e daklarimit financiar të fushatës për zgjedhjet Lokale 2017...

Në bazë të ligjit dhe rregulloreve, afati i fundit ka qenë 6 dhjetor 2017 për subjektet politike që kanë përfunduar garën në raundin e parë, dhe po ashtu, për subjektet politike që kanë përfunduar garën në raundin e dytë, ka qenë afati i fundit, 3 janar 2018.

Në vazhdim, zonja Mavriqi, shpjegoi faktin se s’i vjen në këso raste gjobitja. Ajo, theksoi se Zyra, ka kontaktuar këto subjekte dhe, u aa ka kërkuar raportet, dhe po ashtu, i ka parlargmëruar për saknsionet ligjore.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekaomandimin e ZRPP-së.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli i Operacioneve Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i Vlerësimit të Barazisë Gjinore nga KQZ, Politika e Barazisë gjinore e KQZ-së si dhe Plani i Veprimit të Barazisë Gjinore të KQZ-së:

Adnan Rustemi: KOZ-i, në mbledhjen e kaluar, tha z. Rustemi, ka shqyrtuar tre draft-dokumente që janë çështje e përbashkët e barazisë gjinore kur janë në pyetje masat që do të duhej t’i ndërmerre KQZ-ja në përmbushjen dhe fuqizimin e rolit të gruas. Pra, kur . është në pyetje barazia gjinore, Sekretariati në bashkëpunim me IFES-in, ka përgatitur këto drafte.

Z. Rustemi, zbërtheu draftet në mbledhje, përmbajtjen e tyre, rolin, fushëveprimet, zhvillimi dhe vetëdijësimi ndaj rolit të gruas, barazia, trajnimet etj. Ai, po ashtu, në diskutimin e tij, tha se në këto drafte është edhe plani i veprimit, specifikat, afatet etj., dhe kështu KOZ rekomandon për miratim...

Sami Hamiti: Unë, i kam marrë këto dokumente, i kam analizuar por, shkrimi i tyre në gjuhën shqipe është jashëtzakonisht jashtë standardit të shkrimit, por edhe përkthimi është jo serioz...! Kam vërejtje edhe nga aspekti i shpjegimit lidhur me strukturën e dokumenteve, pastaj hartimi është i mangët...! Në çka jeni thirrë lidhur me hartimin e këtyre dokumenteve...? Janë do organizata, por nuk jeni thirrë në dokumentet kryesore: si përshebull, Karta e Pekinit e vitit 1985 që është themelore për këtë çështje, dhe as Paktit (Marrëveshjes) së Lisabones!

Nuk janë përmendur organizatat bazike, qenësore, tha z. Hamiti. Grupi, në çka është thirrë, pastaj, plani i veprimit është për një vit...Por, ka shkaur gjysma e vitit. Pastaj, renditja në dokument... ! Në anën tjetër, barazia gjinore është për të dy gjinitë, por ka edhe grupe të tjera....! Nëse, ju e keni evidentuar 50%, çka nëse bëhet 51%...? Kjo, ndoshta synohet s'i normë por, në statistikën e Parlamentit Evropian, 20% është përfaqësimi i grave, 25% është në Kroaci, 22% në Shqipëri etj.

Ky dokument, Tha z. Hamiti, vlenë për t'u dëshiruar! Ka bazë, por vështirë është për ta vlerësuar.

Ilir Gashi: Qëllimi i mirë, nënkupton që në insitucionin tonë të rritet sa më shumë barazia gjinore. Mirëpo, dokumentet kur përpilohen duhet të jenë në përputhshmëri me ligjet mbi të cilat vepron ky insitucion. Ne, jemi insitucion specifik, dhe shumëçka nuk varet nga ne! Ne veprojmë me ligjin për zgjedhjet, dhe aty nuk cekete barazia gjinore. Mirëpo, ne nuk vendosim se si barazinë gjinore e zbatojnë subjektet politike. Është bukur vëshitrë që ne, të realizojmë diçka që nuk bie mbi kompetencat tona. Ne, jemi goxha të shtërnguar që të veprojmë në këtë drejtim, pavarësisht nga synimi i mirë....!

I mbështes qëllimet e mira, por nuk jam ithtarë të mbështesë dokumentet që ne, nuk mund t'i realizojmë...! Qysh mund ta zbatojmë ne barazinë gjinore, veç administratës sonë sepse, s'i mund t'ua imponojmë partive idenë dhe synimin në këtë drejtim...?

Eshref Vishi: Disa çështje janë të formuluara edhe në formë të pyetjeve për të shpjeguar më tepër planin e veprimit të cilin e kemi para vetës lidhur me afatin e zbatimit, ose prej kur fillon dhe kur përfundon afati i zbatimit...! E dyta, ky plan veprimi a ka kosto apo implikime material.

Duke e zbërthyer më tej këtë document, z. Vishi tha se duhet ndryshuar rregullativa për të mbërri deri te zbatimi i këtij dokumenti...

Sami Hamiti: Intenca është që rregullativen me e ndryshar në mënyrë që të shkohet deri tek "50%"...! Strategjitë e vendeve të rajonit, e BE-së është me mbërri në 2022 deri te "30%", dhe

ne nuk mund të shkojmë më tej...! Nuk mund të mbërrijmë, dhe problemi kryesor është: ku duhet të fokusohemi. Si statistikë, është 19% e baraziës në nivel botërorë...! Ne, kjo që tha Eshrefi dhe Iliri, as rregullativen nuk mundemi me përfundue Brenda këtij viti...

Adnan Rustemi: Jo, pajtohem me shumë adresime! Dhe, nuk duket që dokument autentik! Nuk është veç ky document, kemi pas ën të kaluaren, do të kemi edhe në të ardhmen. Për shembull, plani strategjik...! Problemi im është se, zbatimi i dokumenteve që na vinë si jo autentike, nuk lidhet si dhe sa duhet me mundësinë e zbatimit, me mendësinë tonë sepse, ka shkëputje, nuk ka kohesizon të duhur...! Mendoj që, ky dokument nuk është normë por janë dokumente që përshkruajn një lloj gatishmërie të KQZ-së me e zbatue brenda kapaciteteve që ka, që, me pas ne, mund të krijojmë disa mundësi, nxitje, shtytje...

Është një plan gatishmërie për të shtyrë përprara këtë agjendë, nëse nuk mund ta shtyjme në kuadër të stafit permanent sepse nuk mund ti lëvizim njerëzit, në stafin jo permanent e kemi mundësinë më të madhe. Në stafet zgjedhore të partive mund të ndikojmë, por s'mund ta garantojmë, në informim publik kemi mundësi ta bëjmë sepse, e kemi pas si komponentë të strategjisë: informim të grave, gjithëpërfshirje ...! Kështu, unë mendoj se kjo dëshmon që ne e kemi gatishmërinë tonë për ta realizue aty ku mundemi, pavarësisht nga vështirësitë që mund t'i kemi...

Ilir Gashi: Kur flitet për KQZ-në, unë nuk e di se s'i mund ta realizojmë kur, është fjala për Sekretariatit, për anëtarët e KQZ-së...Jam në parim për ta mbështetë, por mbi bazën e diskutimeve janë për ta korigju, për ta modifiku sepse, disa gjëra duhet t'i heqim dhe mos të figurojmë...!

Sami Hamiti: Norma në 50%...! Së fundit, është një vendim i MPL që s'ka lidhje me asgjë. Ne, mund të thirremi në atë dispozitë të ligjit...Çka, qysh e bënë në tresh komisionin e aksionarëve, qysh e bënë në tresh komisionin: veç nëse e bënë një mashkull, në femër, një të gjinisë asnjënëse...Qysh e bënë...? Pse ata nuk e bëjnë në vendet e tyre...? Mesatarja evropiane është 19.2! Ne, veç e kemi arritur këtë kuotë. Shiheni parlamentin francez, anglez...? Cila është kuota...?

Demokraci...? Nuk është demokraci kjo, është mishmash...! Merreni dhe shiheni dokumentin nëse e keni lexuar. Se keni lexuar hiq...

Enis Halimi: Dokumenti është bërë bërë në bashkëpunim me IFES-in.

Sami Hamiti: Thuaj, e ka bërë IFES-i...

Enis Halimi: Me aktivitete të këtilla, edhe pse u dhanë shumë vërejtje, ne konsiderojmë se ky dokument përbën një avancim...Si dokument, ky na mundëson të lëvizim përpara, edhe pse jemi përpara, sepse në zgjedhjet e fundit lokale përfaqësimi ka qenë 30. 37%...Ky dokument, meriton të revidohet, të korrigohet nëse sot nuk aprovohet, dhe ne ta sjellim përsëri në mbledhje...

Ilir Gashi: Ne, po e miratojmë këtë dokument me sugjerimet, me vërejtjet që u dhanë etj. Kujdes edhe me komisionet, me kuoten, përmirësojeni...

Ergit Qeli: Me këto sugjerime të shumta që u dhanë, e hedh në votim. Kush është për miratimin e këtij draft dokumenti dhe planin e realizimit të tij...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin lidhur me draft –dokumentin për *Barazinë Gjinore të KQZ, Politikat e Barazisë Gjinore të KQZ-së, si dhe Planin e Veprimit të Barazisë Gjinore të KQZ-së me një votë abstenim (Sami Hamiti)*

4. Këshilli për Buxhet dhe Financa:

1. Shqyrtim i dhe miratimi i Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të KQZ-së, për vitin 2019-2021,

Ilir Gashi: Në mbledhjen e sotme të Këshillit për Buxhet, kemi trajtuar “Kash-in” që, si dokument në këshill e kemi miratuar. E kemi lënë për sot, edhe pse është afati i fundit që do të duhej të dorëzohej, mirëpo për shkak të një proekti që jemi dakorduar që një pjesë e këtij projekti të futet në projektin që, e diskutuan edhe në mbledhjen e kaluar që ishte me AËEB-in, është futur edhe ai projekt. Ne, e kemi dhënë dritën e gjelbër që ky projekt të filloj së realizuar me fazën e parë që është më e lehta, dhe që ka një kosto më të vogël...E kemi miratuar si document, dhe e keni para vetës...

Adnan Rrustemi: Në ç farë shume është përfshi projekti..?

Enis Halimi: Janë 50 000 euro, gjatë vitit 2019, dhe pastaj 450 000 në vitin vijues, e për të kulmuar më 2021...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të KQZ-së, për vitin 2019-2021,

5. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Ercan Spat: Ashtu siç e parajalmërova, KMJ shqyrtoi planin medial që është i paraparë edhe me plan, dhe këshilli rekomandon për aprovimin e tij.

Adnan Rrustemi: Jam dakord si dokument, mirëpo ky dokument ka mundur t'i shërbej Zyres për Informim Publik. Nuk ka ndonjë risi dokumenti...Dokumentit ka veç njoftime, por nuk ka ndonjë aktivitet, ndonjë produkt...Ok, jam dakord...!

6. Tw ndryshme